

UDHËZIM
Nr.42, datë 13.10.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.39, DATË 6.10.2011 TË MINISTRIT TË
ARSIMIT DHE SHKENCËS “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL”
DHE “MASTER I SHKENCAVE/ MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2011-
2012”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional”, për vitin akademik 2011-2012”, të vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011-2012”, si dhe të vendimit nr.241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr.39, datë 6.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave/master i arteve të bukura” të bëhet pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, nga data 10.10.2011 deri në datën 30.10.2011, prej orës 08:00 deri në orën 18:00, ku kandidati duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2.500 lekë, paguar në Postën Shqiptare;

e) Deklaratë që vërteton se kandidati nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, në institucionet e arsimit të lartë publik.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16.00 të datës 4.11.2011, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara sipas vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional”, për vitin akademik 2011-2012”, të vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të

lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011-2012”.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 7.11.2011 deri në datën 10.11.2011 prej orës 08:00 deri në orën 18:00 pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jo fitues t’u kthehen personave kundrejt kërkesës. Për regjistrimin kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të paraqesë në origjinal dokumentet sipas shkronjës “a” dhe “b” të pikës 5 të udhëzimit.

II. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj